

## ANULOHEK HEC-I NË KOLONJË

HEC-i në përroin e Rehovës, në fshatin Kolonjë të Gjirokastër, nuk do të ndërtohet. MIE ka vendosur pezullimin e procesit pas shqetësimit të ngritur nga banorët për impaktin që shkaktonte ndërtimi i kësaj vepre në zonë. Ministrat Belinda Balluku dhe Blendi Klosi zhvilluan një dëgjese me banorët e Kolonjës ku i siguruan se ngritja e HEC-it është anuluar.

## NËNSTACION I RI ELEKTRIK NË KOMBINAT

Ka nisur puna për ndërtimin e nënstacionit të ri në zonën e Kombinatit i cili do të bëjë të mundur furnizimin me energji elektrike me cilësi më të lartë për afro 120 mijë banorë. Me një investim të financuar nga Banka Botërore, me vlerë 10 milionë euro, do të bëhet e mundur rritja e standardeve të shpërndarjes së energjisë, minimizimi i humbjeve, ndërprerjeve apo defektet.

## MASA PËR SEZONIN VEROR

Në pikën kufitare të Morinës janë marrë të gjitha masat për të përballuar fluksin e lartë të udhëtarëve gjatë sezonit turistik dhe për t'ju shërbyer atyre sa më shpejt dhe me cilësi. Nga ana e saj, MIE është e angazhuar për përfundimin e punimeve përgjatë rrugës Kukës-Morinë para nisjes së sezonit turistik, kur ngarkesa e trafikut në këtë aks është më e madhe.

## KONTROLL LINJAVE TË TRANSPORTIT

Task Forca e Transportit Rrugor ka nisur një aksion në të gjitha akset kombëtare për të identifikuar dhe ndëshkuar paligjshmërinë dhe konkurrencën e pandershme në këtë sektor. Rreth 160 subjekte janë ndëshkuar brenda 2 javësh me masa administrative pasi nga kontrollet janë gjetur në shkelje si ndryshim destinacioni, mungesë akt vlerësimi komoditeti dhe në shumë raste me mungesë dokumentacioni.

## PËRFUNDON TUNELI PANORAMIK

Punimet për ndërtimin e tuneli në segmentin Elbasan-Kërrabë, pjesë e autostradës Tiranë-Elbasan, tashmë kanë përfunduar plotësisht. Përfundimi i kësaj vepre, e cila nisi në fund të muajit shtator, bën të mundur eliminimin e rrezikut të rrëshqitjes së dherave në këtë pjesë të aksit si dhe rrit sigurinë për të gjithë përdoruesit e tij. Kjo ishte vepra e fundit në proces pune dhe aksi do të jetë gati në fund të muajit maj.

## RETROPUBLIK, EKSPOZITË E WORKSHOP

Automjetet e koleksionistëve më të apasionuar të Shqipërisë u ekspozuan në ambientet e COD - (Center For Openness And Dialogue) duke ju ofruar mundësi qytetarëve për t'u njohur me to. Koleksionistët diskutuan mes tyre dhe përfaqësuesve të MIE rreth rregullave të reja sa i takon regjistrimit të automjeteve apo lehtësira financiare apo dokumentacioni. Së shpejti rregulla të reja për këto mjete.